VENDIM
Nr.47, datë 7.11.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Sokol Berberi	anëtar I	“	“
Admir Thanza	anëtar I	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	anëtar i	“	“

me sekretare Enina Mullaj, në datën 9.6.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen nr. 20 Akti, që i përket:

KËRKUES: Orik Shyti, përfaqësuar nga avokat Dylber Mani, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga Artur Selmani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si antikushtetues, i vendimeve: nr.44, datë 1.7.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr.40, datë 7.7.2009 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe nr. 00-2010-933 (731), datë 2.7.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 32, 34, 42/2, 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, subjektin e interesuar që u shpreh për rrëzimin e saj dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN
I

1. Kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, së bashku me të pandehur të tjerë, për kryerjen e një sërë veprash penale, kryesisht në Tiranë e Vlorë, gjatë viteve 1993–1996. Për këto episode kriminale fillimisht janë regjistruar procedime penale në Prokurorinë e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Vlorë, të cilat në datën 24.10.1996 janë bashkuar në një procedim të vetëm (nr.1589) nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky procedim penal është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 13.11.1998. Me vendim nr.106, datë 12.2.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pushimin e çështjes, pasi ka interpretuar si tërheqje akuze kërkesën e prokurorisë për kalim aktesh në prokurori, për kryerje të hetimeve të mëtejshme, duke i’u referuar nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.252, datë 30.4.2003, ka vendosur prishjen e vendimit nr.106, datë 12.2.2003, *supra*, kthimin e çështjes për rigjykim me trup tjetër gjykues dhe ka kërkuar në pjesën arsyetuese, që ky trup i ri gjykues të respektojë nenin 377 dhe t’ia kalojë aktet Prokurorisë, përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga kërkuesi me anë të mbrojtësit të tij dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit me motivacionin se “nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas kthimit të çështjes për rigjykim, me vendim nr.744, datë 4.9.2003, ka vendosur kalimin e akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila pas kryerjes së disa

veprimeve hetimore të tjera, ka shpallur moskompetencën e mëtejshme lëndore të saj për hetimin e çështjes dhe ja ka përcjellë aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

2. Pas regjistrimit të procedimit penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (nr.106 akti, datë 14.9.2004, supra). Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë, pas administrimit të provave për secilin nga episodet kriminale, objekt gjykimi, me vendimin nr. 44, datë 1.7.2008, ka vendosur ta shpallë fajtor kërkuesin për veprat penale si vijon: **a)** "Vjedhje me armë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës "Vefa"; **b)** "Vjedhje me armë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të degës së Bankës Kombëtare Tregtare Vlorë; **c)** "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", me pasojë vdekjen e shtetasit Bujar Kaloshi; **ç)** "Vjedhje me dhunë" në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të argjendarisë "Agron"; **d)** "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë "IAP"; **dh)** Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë "IAP" (e përsëritur); **e)** "Vrasje me dashje e kryer për interes" e mbetur në tentativë, në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shtetasit Eduart Trimi; **ë)** "Vjedhje me pasojë vdekjen", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shtetasit Pirro Konini; **f)** "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë "Albfoam"; **g)** "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të Ndërmarrjes së Lëndëve Djegëse; **gj)** "Vjedhje me pasojë vdekjen", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shtetasit Sami Jata; **h)** "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës "Shkumbin Petrol"; **i)** "Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të Degës së Bankës së Kursimeve Vlorë; **j)** "Rrëmbim ose mbajtje peng e personit në rrethana lehtësuese", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të fëmijës Erion Nushi; **k)** "Vepra të dhunshme ndaj pasurisë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale; **l)** "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të viktimës Vera Dume; **ll)** "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të viktimës Hasim Karamani; **m)** "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të viktimës Vait Osmani; **n)** "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të viktimës Muhamet Karamani; **nj)** "Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të degës së Bankës së Kursimeve Tiranë; **o)** "Falsifikim i dokumenteve"; **p)** "Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave"; pushimin e çështjes penale për veprën penale "Falsifikim të akteve të gjendjes civile", për shkak amnistie, dhe në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 55 të Kodit Penal, për caktimin e dënimeve për disa vepra penale, ka vendosur të dënojë kërkuesin me burgim të përjetshëm.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.40, datë 7.7.2009, ka vendosur:

i) Lënien në fuqi të vendimit nr.44, datë 1.7.2008, në lidhje me kualifikim ligjor, fajësinë e kërkuesit dhe masat e dënimit për veprat penale, si vijon:

- "Vjedhje me armë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës "Vefa" **(a)**;
- "Vjedhje me armë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të Degës së Bankës Kombëtare Tregtare Vlorë **(b)**;
- "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese", me pasojë vdekjen e shtetasit Bujar Kaloshi; **(c);**
- "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të argjendarisë "Agron" **(ç)**;
- "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë "IAP" **(d)**;
- "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të shoqërisë "Albfoam" **(f)**;
- "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të

Ndërmarrjes së Lëndëve Djegëse **(g)**;

- "Vjedhje me dhunë", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të firmës "Shkumbin Petrol" **(h)**;

- "Rrëmbim ose mbajtje peng e personit në rrethana lehtësuese", në bashkëpunim, në formën e organizatës kriminale, në dëm të fëmijës Erion Nushi; **(j)**;

- "Falsifikim i dokumenteve"**(o)**;

- "Falsifikim i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave **(p)**; si dhe pushimin e çështjes për veprën penale "Falsifikim të akteve të gjendjes civile".

ii) Ndryshimin e vendimit nr. 44, datë 1.7.2008, për veprat penale, si vijon (shih paragrafin 2, *supra*):

- "Vjedhje me dhunë" në dëm të shoqërisë "IAP" **(dh)** dhe "Vrasje me dashje e kryer për interes" e mbetur në tentativë **(e)** ndryshohen në "Grabitje" sipas Kodit Penal të vitit 1977 dhe Kodit Penal të kohës së kryerjes së veprës; dënimi ndryshohet nga 7 dhe 12 vjet burgim, në një dënim unifikues për të dyja veprat[1] prej 15 vjetësh;

- "Vjedhje me pasojë vdekjen" në dëm të shtetasit Pirro Konini **(ë)** ndryshohet në 'Grabitje me pasojë vdekjen' sipas Kodit Penal të vitit 1977 dhe Kodit Penal të kohës së kryerjes së veprës; dënimi ndryshohet nga burgim i përjetshëm në 25 vjet burgim;

- "Vjedhje me pasojë vdekjen" në dëm të shtetasit Sami Jata **(gj)**, ndryshohet në "Grabitje me pasojë vdekjen" sipas Kodit Penal të vitit 1977 dhe Kodit Penal të kohës së kryerjes së veprës; dënimi ndryshohet nga 22 vjet burgim në 20 vjet;

- Dënimi për "Vjedhjen e bankave dhe arkave të kursimit" në dëm të degës së Bankës së Kursimeve Vlorë **(i)** dhe "Vjedhjen e bankave dhe arkave të kursimit" në dëm të degës së Bankës së Kursimeve Tiranë **(nj)** ndryshohet nga 10 dhe 12 vjet burgim në një dënim unifikues për të dyja veprat penale prej 15 vjetësh;

- "Vepra të dhunshme ndaj pasurisë" **(k)**; "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër" në dëm të viktimës Vera Dume, **(l)**; "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër" në dëm të viktimës Hasim Karamani, **(ll)**; "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër" në dëm të viktimës Vait Osmani, **(m)**; "Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër" në dëm të viktimës Muhamet Karamani, **(n)**; ndryshohet në "Vepër me qëllime terroriste" sipas Kodit Penal në fuqi dhe dënimi i dhënë është burgim i përjetshëm;

dhe përfundimisht e ka dënuar kërkuesin me burgim të përjetshëm.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-933 (731), datë 2.7.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

5. Kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese *(në vijim Gjykata)*, ku kërkon shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.44, datë 1.7.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, vendimit nr.40, datë 7.7.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe vendimit nr.00-2010-933 (731), datë 2.7.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

6. Kërkuesi ka parashtruar përpara Gjykatës se:

6.1 Është gjykuar sërish për të njëjtat vepra penale, në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës, Konventën europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) dhe nenin 7 të KPP-së;

6.2 Është gjykuar tej çdo afati të arsyeshëm, në kundërshtim me nenin 42/2 të Kushtetutës dhe nenin 6, pika 1 të KEDNJ-së;

6.3 Është deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, në kundërshtim me nenin 32/2 të Kushtetutës dhe nenet 5/2, 128, 129, 151/4 dhe 370/2 të KPP-së;

6.4 Gjykata ka shkelur parimin e barazisë së armëve, duke mos administruar prova të kërkuara nga mbrojtja dhe duke mos arsyetuar vendimet, në kundërshtim me nenet 142/1 të Kushtetutës dhe nenet 112/3, 383/1 dhe 384/1 të KPP-së;

[1] Këto vepra kanë lidhje shkakësore me njëra tjetrën.

6.5 I është shkelur e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm, në kundërshtim me nenin 30 të Kushtetutës, nenin 6/2 të KEDNJ-së si dhe nenet 4 dhe 3/2 të KPP-së;

6.6 Është shkelur parimi i paanshmërisë së gjykatës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kryesohej nga z. Gani Dizdari, i cili ka qenë zv/Prokuror i Përgjithshëm në kohën kur ka filluar procedimi i parë penal ndaj kërkuesit (nr.1589, datë 13.10.1996) dhe në këtë cilësi ka kryer veprime që lidhen me këtë procedim penal.

7. ***Subjekti i interesuar***, Prokuroria e Përgjithshme, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare prapësimet në këto drejtime kryesore:

7.1 Nuk është cenuar parimi *ne bis in idem*, pasi vendimi nr.106, datë 12.2.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur pushimin e çështjes, nuk është i formës së prerë;

7.2 Provat e marra në gjykim nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk janë marrë në kundërshtim me ligjin;

7.3 Çështja ka qenë komplekse dhe për këtë arsye procesi gjyqësor ka qenë i gjatë, por sidoqoftë nuk ka marrë një kohë tej asaj kohe që përdoret për trajtimin nga sistemi gjyqësor shqiptar i çështjeve penale të ngjashme;

7.4 Pretendimi i shkeljes së barazisë së armëve nuk është argumentuar nga kërkuesi;

7.5 Gjykatat nuk e kanë filluar procesin duke e prezumuar kërkuesin të fajshëm;

7.6 Vendimet e gjykatave, duke përfshirë dhe vendimin e Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, janë të arsyetuara.

II

A. Për pretendimin e gjykimit tej një afati të arsyeshëm

8. Kërkuesi pretendon se është gjykuar *tej çdo afati të arsyeshëm*, duke argumentuar se procesi penal ndaj tij ka filluar që në vitin 1996 dhe vendimi i formës së prerë mban datën 2.7.2009. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 19.7.2005; nr.35, datë 27.10.2010; nr.12, datë 15.4.2011).*

9. Nga një shqyrtim i hollësishëm i materialeve të dosjes gjyqësore është i kuptueshëm kompleksiteti i procesit gjyqësor në fjalë, duke pasur parasysh numrin e të pandehurve dhe të akuzave të veçanta për secilin, rrethanat e çështjes, kohën që i është dashur prokurorisë për mbledhjen e provave dhe formulimin e akuzave. Autoritetet gjyqësore dhe ato të ndjekjes penale (bashkërisht "organi procedues") kanë shqyrtuar një numër të madh dokumentesh për secilin nga personat e përfshirë në proces. Natyra e akuzave dhe problemet e kompetencës në lidhje me organet e ndjekjes penale, që kanë dalë në pah gjatë procesit, e kanë bërë edhe më komplekse çështjen. Përveç sa më sipër, Gjykata çmon se në zgjatjen e procesit ka ndikuar edhe fakti që kjo çështje, mbi bazën e ankimeve, ka kaluar dy herë të gjitha instancat gjyqësore.

10. Gjatë procesit gjyqësor në ngarkim të kërkuesit janë zhvilluar një numër i konsiderueshëm seancash gjyqësore. Nga procesverbalet e seancave provohet se për të njoftuar kërkuesin dhe të pandehurit e tjerë, seancat gjyqësore janë ndërprerë disa herë në respektim të neneve 139, 351/4, 351/1 dhe 352/2 të KPP-së. Pas përpjekjeve për të njoftuar kërkuesin, fillimisht në banesën e tij ku nuk u gjet e më pas me anë të letërporosive në shtetet ku rezultonte të ishte, Gjykata e Krimeve të Rënda, pasi krijoi bindjen se kërkuesi ishte në dijeni të procesit në ngarkim të tij, e deklaroi atë në mungesë. Periudha kohore, duke filluar nga data 14.9.2004 deri në datën 7.3.2005, është konsumuar nga organi procedues për njoftimin e të pandehurve. GJEDNJ-ja ka nënvizuar se në çështjet penale "afati i arsyeshëm", të cilit i referohet neni 6§1 i KEDNJ-së, fillon nga momenti që një person është i "akuzuar" për një vepër penale; kjo mund të ndodhë në një datë para se çështja të vijë para gjykatës, siç mund të jetë data e arrestimit, data kur personi në fjalë është njoftuar zyrtarisht se ai do të ndiqet penalisht ose data kur janë hapur hetimet paraprake *(shih çështjet Von Hoffen kundër Litenshtejnit, 2 korrik 2006 §.35; Hozee kundër Holandës, 22 maj 1998 § 43)*. Në datën 10.10.1998, avokatit të kërkuesit i është njoftuar akuza dhe për efekt të vlerësimit të afatit të arsyeshëm të procesit gjyqësor është kjo datë e cila merret parasysh si

moment i fillimit të këtij afati.

11. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve kompetente, Gjykata çmon se një numër i madh seancash janë shtyrë, për arsye të cilat i atribuohen organit procedues (gjykata dhe prokuroria bashkërisht). Duke i'u referuar procesverbaleve të seancave në dosjen gjyqësore, konstatohet mungesa e gjyqtarëve për arsye objektive, ndër të cilat mund të përmendim pjesëmarrjen në gjykim të çështjeve të tjera, raportin shëndetësor apo marrjen e kohës për t'u njohur me çështjen. Seancat gjyqësore janë shtyrë edhe për mungesë të prokurorëve për shkaqe të lidhura kryesisht me zëvendësimin e tyre ose marrjen e kohës për t'u njohur me çështjen. Krahas mungesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, vërehet se seancat janë shtyrë edhe për arsye të mungesës së sekretares së gjykatës. Në këto kushte, Gjykata nënvizon se sjellja e organit procedues në tërësi ka shkaktuar vonesa në gjykim.

12. Sjellja e kërkuesit është marrë në konsideratë dhe është vlerësuar nga Gjykata në kompleksitet me kriteret e tjera të përcaktuara nga GJEDNJ-ja. Nga procesverbalet e seancave gjyqësore, vihet re se mungesa e mbrojtësit të kërkuesit apo mbrojtësve të të bashkëpandehurve të tjerë, kryesisht me motivacionin e pjesëmarrjes në gjyqe të tjera, është bërë shpesh shkak për shtyrjen e seancave. Në disa raste seancat janë shtyrë për arsye se nga ana e mbrojtjes nuk janë siguruar në kohë provat shkresore ose janë paraqitur të parregullta nga ana formale. Gjykata konstaton në çështjen konkrete se, në rastet e mungesës së mbrojtësve, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk është treguar pasive në lidhje me këtë sjellje të palës, por ka vënë në dijeni Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën e Avokatisë për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve.

13. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se kompleksiteti i çështjes, sjellja e organit procedues dhe e kërkuesit janë bërë shkak për zgjatjen e procesit gjyqësor tej afateve të arsyeshme. Pavarësisht se vonesat, që i atribuohen organit procedues, kanë ndodhur për shkaqe objektive dhe hapësirat legjislative kanë lejuar rishqyrtimin e çështjes, në çmuarjen e Gjykatës, zvarritja e procesit nga autoritetet shtetërore është e pajustifikueshme. Edhe pse në kushtet e mungesës së një mjeti juridik specifik për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga mosrespektimi i standardit kushtetues të afatit të arsyeshëm, Gjykata thekson se është detyrë e autoriteteve kompetente, duke përfshirë Prokurorinë e Përgjithshme, gjykatat, Ministrinë e Drejtësisë, si dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të marrin masat për të siguruar miradministrimin e proceseve gjyqësore dhe mënjanimin e shtyrjeve së tyre tej afateve të arsyeshme.

14. Nisur nga sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

15. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi kryesuesi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qenë Zëvendësprokuror i Përgjithshëm në kohën kur kërkuesi procedohej penalisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj dhe në këtë cilësi ka kryer veprime që lidhen me këtë procedim penal. Një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. Gjykata merr parasysh, *inter alia*, veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk ofrojnë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë *(shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

16. Gjykata ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së

trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në Dhomën e Këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm. Gjykata ka theksuar se "...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar, se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje" (*shih vendimet nr.21, datë 29.4.2010; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 48, datë 30.7.1999 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Edhe GJEDNJ-ja e ka trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e saj respektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Në çështjen *Kyprianou kundër Qipros*, datë 15 dhjetor 2005, §118, GJEDNJ-ja ka theksuar se "është shumë e rëndësishme në një shoqëri demokratike që gjykata të ngjallë besim tek publiku dhe tek i akuzuari". Kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që pretendojnë anshmërinë është i rëndësishëm por jo vendimtar. Vendimtare është nëse ky shqetësim mund të konsiderohet objektivisht i justifikuar *(shih Ferrantelli and Santangelo, supra, § 58; Wettstein kundër Zvicrës, datë 21 dhjetor 2000, §44).* Në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit për paanshmërinë e gjyqtarit ka karakter funksional; nuk goditet sjellja e tij, por ushtrimi i dy funksioneve nga i njëjti person brenda të njëjtit proces, që objektivisht justifikon dyshime në lidhje me paanshmërinë e gjykatës. Sipas kërkuesit, por edhe nga verifikimet e materialeve të dosjes, rezulton se Kryetari i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka ushtruar detyrën e prokurorit në gjyqin ndaj të atit të kërkuesit, në vitin 1993, dhe detyrën e Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm në kohën kur kishte filluar procedimi penal ndaj kërkuesit.

18. Gjykata e çmon të arsyeshme të ndalet në rolin dhe pozitën kushtetuese të organit të prokurorisë, në strukturën institucionale shtetërore, si edhe kompetencat kushtetuese e ligjore të këtij institucioni. Kushtetutbërësi e ka njohur Prokurorinë si një organ të centralizuar, që në ushtrimin e kompetencave i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve *(vendim nr.14, datë 21.7.2008 i Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka vlerësuar se "organi i prokurorisë ka disa veçori të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj, të cilat e vendosin këtë organ në një pozitë të dallueshme nga pushtetet e tjera, dhe veçanërisht: **a)** si organi i vetëm në vend që ushtron ndjekjen penale; **b)** si organ që përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që disponon mbi çështjet që ndodhen në gjykim dhe që është i lirë në kërkimin e llojit dhe të masës së dënimit ndaj personave që i rezultojnë fajtorë; **c)** si organ me pavarësi të plotë në ushtrimin e funksioneve, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, gjë që do të thotë se fillimi i procedimit penal, vënia para përgjegjësisë penale, pushimi, pezullimi i çështjeve ose dërgimi në gjyq, janë atribute të prokurorisë; **ç)** si organ i centralizuar që funksionon sipas rregullit se urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët" *(shih vendimin nr.26, datë 4.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese)*

19. Duke pasur parasysh çka më sipër, në lidhje me strukturën e centralizuar të Prokurorisë, që operon si një organ shtetëror unik dhe i pandashëm, Gjykata vlerëson si të mirëqenë faktin që Zëvendësprokurori i Përgjithshëm, për arsye të funksionit që mban, jo vetëm ka njohuri, por është i përfshirë në të gjitha çështjet që shqyrtohen nga Prokuroria e Përgjithshme dhe orientimet që jepen për to.

20. Nga materialet e paraqitura evidentohet se Kryetari i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në cilësinë e Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm, ka firmosur disa shkresa që kanë lidhje me procedimin penal ndaj kërkuesit. Më konkretisht, në shkresën nr.1392, datë 25.10.1196, drejtuar grupit të hetimit të çështjes penale në ngarkim të grupit "Hakmarrja shqiptare e drejtësisë", përcaktohet procedura që duhet ndjekur lidhur me shpalljen e kërkimit ndërkombëtar për persona të kategorisë "shumë të kërkuar". Në fund të shkresës, Zëvendësprokurori i Përgjithshëm shprehet me fjalët *"do të kërkoni vendosjen e masës shtrënguese dhe ekstradimin"* çka përbën dhënien e një urdhri të drejtpërdrejtë prokurorit të zakonshëm. Në shkresën nr.1413/40, datë 27.11.1996, Zëvendësprokurori i Përgjithshëm i kërkon Gjykatës së Rrethit Tiranë t'i vërë në dispozicion Prokurorisë së Përgjithshme materiale hetimore për zhvillimin e hetimeve në lidhje me procedimin penal ndaj kërkuesit. Me anë të shkresës nr.523, datë 12.8.1997, Zëvendësprokurori i Përgjithshëm i kthen përgjigje të ëmës së kërkuesit në lidhje me gjendjen e

autoveturave të sekuestruara në procedimin penal ndaj kërkuesit.

21. Në vijim, duke pasur parasysh çka më sipër, Gjykata vlerëson se kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t'i shmanget gjykimit, në mënyrë që të mos cenojë rregullsinë e procesit gjyqësor për sa i përket aspektit të paanshmërisë së gjykatës. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se përfshirja e gjyqtarit në procesin penal ndaj kërkuesit, kur ai ka ushtruar rolin e Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm, nuk ka qenë e papërfillshme ndaj dhe dyshimi i kërkuesit është i bazuar nga ana objektive. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit, që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme, duhet pranuar.

C. Për pretendimet e tjera

22. Për sa i përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, Gjykata ka vlerësuar si vijon:

a) Në lidhje me pretendimin se është gjykuar dy herë për të njëjtat vepra penale

Kërkuesi pretendon se është gjykuar dy herë për të njëjtat vepra penale pasi sipas tij vendimi nr.106, datë 12.2.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është përfundimtar dhe përbën *res judicata*. Parimi *ne bis in idem*, është një instrument kryesor juridik, një garanci thelbësore e individit, e përfshirë në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut[2], që rregullon marrëdhëniet në fushën penale të brendshme dhe ndërkombëtare. Ky parim nënkupton se asnjë individ nuk mund të gjykohet apo dënohet përsëri për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është shpallur i pafajshëm ose është dënuar më parë me një vendim të formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Sipas jurisprudencës kushtetuese, kriteri "e njëjta vepër" i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, vepër penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar (*shih vendimet nr.33, datë 22.7.2011; nr.5, datë 8.3.2005 të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka çmuar *se res judicata* nënkupton, në aspektin formal e procedural, mosankueshmërinë e vendimit, ndërsa, në atë substancial, fuqinë e detyrueshme të vendimit *(shih vendim nr. 29, datë 21.12.2006).* Në çështjen në shqyrtim, vendimi nr.106, datë 12.2.2003 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilit i referohet kërkuesi, nuk i plotëson kriteret e mësipërme, pasi nuk ka forcë detyruese dhe është bërë objekt ankimi në Gjykatën e Apelit. Në këto kushte, edhe pse çështja, për arsye të moskompetencës[3], ka kaluar për shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, e cila është një gjykatë e ndryshme nga ajo fillestare dhe pjesa më e madhe e veprave penale, objekt gjykimi, kanë qenë të njëjta në të dyja gjykimet në shkallë të parë, në rastin konkret kemi të bëjmë me hallkat e një procesi gjyqësor në vazhdimësi, që është zhvilluar në përputhje me dispozitat penale në fuqi. Për këto arsye, Gjykata çmon se parimi ne *bis in idem* nuk është shkelur dhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosgjykimit dy herë për të njëjtën vepër është i pambështetur.

b) Në lidhje me pretendimin se është deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

Kërkuesi pretendon se provat e paraqitura nga akuza janë marrë në mënyrë të paligjshme, në shkelje të nenit 32/2 të Kushtetutës dhe neneve 5/2, 128, 129, 151/4 dhe 370/2 të KPP-së dhe për rrjedhojë janë të pavlefshme. Më konkretisht, sipas kërkuesit, disa procesverbale janë të papërdorshme për arsye të mungesës së nënshkrimit nga të gjithë personat pjesëmarrës në këqyrje, ose për arsye se përmbajnë nënshkrime të personave që nuk kanë marrë pjesë në këqyrje. Gjithashtu kërkuesi pretendon se është shpallur fajtor mbi bazën e deklarimeve të nënshkruara nën efektin e "torturës" dhe që nuk përmbajnë nënshkrimin e mbrojtësit. Sipas jurisprudencës kushtetuese, tashmë të konsoliduar, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009; nr.19, datë 18.9.2008; nr.7, datë 27.4.2005; nr.95, datë 27.7.2001 të Gjykatës Kushtetuese).* Parimi bazë kushtetues që lidh provat me

[2] Shih nenin 4, Protokolli VII i KEDNJ; nenin 14, § 7 të Marrëveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; nenin 50 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

[3] Në këtë kontekst duhet sqaruar gjithashtu se Gjykata e Krimeve të Rënda nuk ishte krijuar ende kur çështja është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prandaj problemi i kompetencës ka dale në një fazë të mëvonshme, pikërisht pas përfundimit të gjykimit në shkallën e parë.

procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Ky parim i rëndësishëm trajtohet edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, në drejtim të respektimit të së drejtës për t'u mbrojtur. Në çështjen Bykov kundër Rusisë, datë 10 mars 2009, § 90, GJEDNJ-ja ka theksuar se për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore, në çështjen konkrete, Gjykata vëren se është lejuar marrja në cilësinë e provës vetëm të atyre deklaratave ku të pandehurve iu është bërë e qartë e drejta për të pasur mbrojtës gjatë pyetjeve dhe prej tyre është dhënë pëlqimi për t'u pyetur pa praninë e mbrojtësit. Këto deklarime janë vlerësuar në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre, në respektim të dispozitave procedurale penale. Bindja e gjykatës për fajësinë e kërkuesit është formuar jo vetëm në bazë të provave të kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuesi, por duke u mbështetur në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit, si procesverbale të këqyrjes, fotografi, ekspertime tekniko-balistike, akt-ekspertime, dëshmitarë. Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente provuese të mjaftueshme që të evidentojë se dëshmitarët i janë nënshtruar torturës, në mënyrë që Gjykata të bëjë një vlerësim të ndryshëm nga ai që kanë bërë gjykatat e zakonshme lidhur me këtë aspekt. Në vlerësimin e Gjykatës kërkuesi i ka ngritur pretendimet në lidhje me mënyrën e marrjes së provave përpara gjykatave të zakonshme, çka nënkupton se atij i është dhënë mundësia për të vënë në dukje mangësitë e provave nga ana formale, si dhe për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit se provat në proces janë marrë në mënyrë të paligjshme është i pabazuar.

c) Në lidhje me pretendimin se është shkelur parimi i barazisë së armëve

Kërkuesi këtë pretendim e mbështet te mosadministrimi nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i provave të kërkuara nga mbrojtja dhe mosarsyetimi i vendimeve për mospranimin e këtyre provave. Gjykata ka ritheksuar se, veçanërisht në procesin penal, parimi i barazisë së armëve përbën një nga elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Ky standard kushtetues nënkupton që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme, për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër, në funksion të realizimit të një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes *(shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009; ; nr.10, datë 2.4.2009; nr.19, datë 18.9.2008; nr.13, datë 21.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese).* Lidhur me mospranimin e provave të kërkuara nga mbrojtja, Gjykata e ka ripohuar tashmë qëndrimin e saj të konsoliduar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykata dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e gjykatave të zakonshme *(shih vendimet nr. 37, datë 19.9.2011; nr.106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues *(shih vendimin nr.14, datë 3.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese)*. Edhe GJEDNJ-ja është shprehur se "neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt, por nuk përcakton rregullat për pranimin e provave si të tilla, çështje e cila i përket kryesisht rregullimit sipas legjislacionit të brendshëm" (*shih Schenk kundër Zvicrës, 12 korrik 1988, § 45).* Nga analiza e dosjes gjyqësore vërehet se në të gjitha shkallët e gjykimit mbrojtësit të kërkuesit i është dhënë mundësia për të dëgjuar dhe debatuar të gjitha provat e paraqitura nga akuza dhe vendimet e gjykatës për mospranimin e provave të kërkuara nga mbrojtja nuk paraqesin elementë të cenimit të standardit të *barazisë së armëve*. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

ç) Në lidhje me pretendimin për mosarsyetimin e vendimit gjyqësor

Kërkuesi pretendon se vendimet e gjykatave nuk janë arsyetuar, pasi nuk përmbajnë një analizë të provave të shqyrtuara. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai

duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*Shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009; nr.7, datë 9.3.2009 dhe nr.33, datë 8.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).* Në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton që vendimet gjyqësore të jenë jologjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementët e përmendur më sipër. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se vendimet e gjykatave nuk cenojnë kërkesat që lidhen me arsyetimin e vendimit gjyqësor në kuptimin kushtetues dhe pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i pabazuar.

d) Në lidhje me pretendimin se i është cenuar e drejta e prezumimit të pafajësisë

Për këtë pretendim kërkuesi ka parashtruar dy argumente: së pari, gjykata, duke u mbështetur në prova të marra në mënyrë të paligjshme, ka prezumuar fajësinë e tij; dhe së dyti, zyrtarë të shtetit të kohës kanë bërë deklarata të ndryshme publike në lidhje me fajësinë e tij, pa mbaruar ende procesi gjyqësor. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza *(shih vendimet nr.23, datë 23.7.2009, dhe nr.9, datë 28.4.2004 të Gjykatës Kushtetuese).* Prezumimi i pafajësisë është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ-ja, e cila në çështjen Allenet de Ribemont kundër Francës, datë 10 shkurt 1995,§35, ka theksuar se "prezumimi i pafajësisë është një nga elementët e procesit të rregullt ligjor që parashikohet në nenin 6 par. 2. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal mjafton që të ketë një arsyetim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor" *(përkthim i Gjykatës).* Nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura Gjykatës, nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se anëtarët e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen, e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Bazuar në sa më sipër, Gjykata çmon se nuk është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë ndaj kërkuesit.

23. Si përfundim, për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesit, në kuptim të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-933 (731), datë 2.7.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, njëzëri.

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm (votuan kundër: V. Tusha dhe A. Xhoxhaj).

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar,) Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Sokol Sadushi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza.